

Për ndryshim sipas
procedurës
06/05/2019 Vashku



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 582 Prot
1

Tiranë më 03.05.2019

Lënda: Propozim për ndryshim të kategorizimit të pagës për dy pozicione pune të shërbimit civil

KRYETARIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË

Zotit Gramoz RUÇI

T i r a n ë

I nderuar Z. Kryetar,

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është i organizuar në bazë të strukturës dhe organikës të miratuar nga vendimin nr. 98/2014 *“Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”*.

Bazuar në këtë strukturë pozicionet e punës *“Specialist i Marrëdhënieve me Publikun dhe Burimeve Njerëzore”* me kategori page IV-a dhe *“Specialist IT”*, me kategori page IV-a, të vendosur në Drejtorinë e Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse, janë struktura të vetme në institucion të cilat kryejnë detyra të veçanta funksionale.

Nisur nga përshkrimet e punës, kërkesat e posaçme të miratuara për këto pozicione, si dhe detyrat që realizojnë, konstatohet se ato i përkasin pozicionit *“Specialistit i nivelit të lartë”*, me kategori page III-b, të parashikuar në lidhjen nr. 4, që i bashkëlidhet vendimit nr.187, datë 8.3.2017 të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit (1)(2)”*

Detyrat funksionale që kryejnë dy pozicionet e punës për të cilat propozojmë ndryshimin e kategorizimit të pagës, janë të parashikuara në përshkrimet e punës, si dhe në nenet 18 dhe 19 të Rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil” të miratuar me vendimin nr.18, datë 11.3.2015 nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Për arsyet e parashtruara si më sipër, si dhe referuar institucioneve të tjera analoge me Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, institucioneve të pavarura, të përmendura në pikën 1/1 të vendimit nr. 187 datë 8.3. 2017 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrave të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit (1)(2)”, **propozojmë që kategoria e pagës për pozicionet e punës “Specialist i Marrëdhënieve me Publikun dhe Burimeve Njerëzore” dhe “Specialist IT”, të bëhet III-b.**

Bashkëlidhur me këtë shkresë po ju dërgojmë dokumentet që identifikojnë pozicionet e punës dhe detyrat që ato realizojnë:

1. Strukturën dhe organikën aktuale të institucionit.
2. Rregulloren e Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”.
3. Përshkrimet e punës për pozicionet “Specialist i Marrëdhënieve me Publikun dhe Burimeve Njerëzore” dhe “Specialist IT”.
4. Organika e propozuar me ndryshimin e kategorive të pagave për pozicionet “Specialist i Marrëdhënieve me Publikun dhe Burimeve Njerëzore” dhe “Specialist IT”.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha

